Janë shpërndarë gjithësej 1.155 metra dru, ndërsa vlera e përgjithshme e këtij projekti është 39.578 euro, duke llogartitur këtu edhe shpenzimet për transport deri te shtëpitë e përfutuesve, të cilëve iu janë dhënë nga 3 metra dru të gatshme për djegie. Komuna ka ndarë për këtë qëllim, nga fondi për nevoja emergjente, 26.089 euro.

Dy përfaqësues të Qeverisë holandeze, znj. Marije Balt dhe z. Carel Brands kanë vizituar në fillim të muajit mars komunën e Gjilanit, ku do të realizohet një projekt për riintegrimin e komunitetit, i financuar nga Holanda dhe janë takuar me banorët e lagjes “Abdullah Presheva” si dhe me kryetarin e komunës, Lutfi Haziri. Në këtë lagje, ku jetojnë bashkarisht shqiptarët dhe komuniteti rom, tanimë kanë filluar parapërgatitjet për ndërtimin dhe meremetimin e afro 70 shtëpive për të zhvendosurit që janë shprehur të gatishëm të kthehen nga komuna e Bujanocit, si dhe për komunitetin vendor. Projektin për lagjen “Abdullah Presheva”, do të realizohet nga ARC-ja, në bashkëpunim me komunën.

*** United Nations Office for Project Services / UNOPS**

Ministria e Ekonomisë dhe Financave ka filluar me një projekt të ri të quajtur “Axhendat Zhvillimore për Programin e Koordinimit të Ndhimave” që është duke u ekzekutuar nga Organizata e Kombeve të Bashkuara për ShërbimE Projektsh (UNOPS) në Komunat regjioneve të Gjilanit dhe Prizrenit.

Ky projekt synon: Së pari / Hartimin dhe botimin e axhendave të reja zhvillimore komunale, bërjen e një plani strategjik për zhvillimin e gjithëanshëm të komunës (afati kohor 2004-2006) si dhe përpilimin e një plani aksioni/veprimesh që do shërbeje si instrument monitorues për zbatimin e kësaj strategjie. Së dyti / Për institucionalizimin e procesit të planifikimit të zhvillimit në nivel komunal. Së fundi / Tubimin e kontributeve apo mjeteve financiare për të mundësuar zbatimin e kësaj strategjie komunale (këtu do të luajë një rol të rëndësishëm edhe drejtoria e kordinimit të ndihmave pranë MEF).

*** Parner Aid International Kosovo / PAI**

Kjo organizatë është e përqendruar në investime për rregullimin e kopshteve / lojrave për fëmijë, klasave verore në objektet shkollore dhe qerdhjet e fëmijëve / përfaqësues i organizates është z. Hendrik Strunk / , gjatë muajit shkurt kemi vizituar shumë shkolla dhe qerdhe dhe kemi parë se nevojë prioritare është investimi në qerdhe të fëmijëve / Ardhmëria I dhe Ardhmëria II dhe kemi vizituar shkollën Selami Hallaqi dhe parkun mbi hallen e sporteve / afër varresave / . Në bashkëpunim me PAI kemi vendosur se është e nevojshme investimi në rehabilitimin e parkut mbi hallen e sporteve / afër varresave që me sukses është bërë implementimi i këtij projekti .

*** Institutin për Hulumtime Zhvillimore/RIINVEST & Institutin për Shoqëri të Hapur / OSI**

Më 29.12.03 Instituti për Hulumtime Zhvillimore (RIINVEST) dhe Instituti për Shoqëri të Hapur (OSI) në Budapest i ftojnë të gjitha komunat që të bëjnë kërkesë për pjesëmarrje në projektin DELTA II. Projekti do të fillojë të realizohet në janar 2004 dhe në të do të përfshihen 5 komuna me sukseseshme . Riinvesti në bashkëpunim me OSI-në do të formojnë listën e ngushtë prej 10 komunave të cilat do të intervistohen. Afati për dorëzimin e aplikacioneve është deri më 9 janar '04. Gjilani është njëra nga pesë komunat e Kosovës, e cila, në një konkurrencë jashtëzakonisht të madhe, është përzgjedhur nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore (Riinvest) si dhe Instituti për Shoqëri të hapur (OSI) në projektin për zhvillimin e ndërmarrjeve lokale nëpërmjet aksioneve dhe aleancave “Delta II”.

Programi parashehë organizimin e katër punëtorive, hartimin dhe aprovimin e strategjive të zhvillimit ekonomik lokal, hartimin e projekteve dhe implementimin e tyre, organizimin e një konference të donatorëve si dhe udhëtimet studiuëse të zyrtarëve në botën e jashtme .

Komuna e Gjilanit edhe deri tani është dëshmuar e suksesshme në projektet e këtilla dhe ajo i vlerëson si shumë të nevojshme bashkëpunimin reciprok dhe krijimin e lidhjeve midis institucioneve të ndryshme, të cilat po japin kontribut në nxitjen dhe stimulimin e zhvillimit ekonomik në Kosovë.

Në kushtet bashkëkohore është shumë i rëndësishëm shkëmbimi i përvojave me institucionet e këtilla serioze siç janë “Riinvest” dhe “OSI” dhe me vendet në tranzicion, sepse kjo ndihmon zhvillimin strategjik.

Aftësimi i komunave për zhvillimin ekonomik lokal mund të definohet si punë e përbashkët e njerëzve lokalë dhe institucioneve të ndryshme me përvojë për të siguruar ngritje të ekonomisë, e cila garanton cilësi më të mirë të jetës.

Përzgjedhja e Gjilanit në këtë projekt do të thotë se kjo komunë është e aftë të koordinojë faktorët e ndryshëm lokalë dhe të shfrytëzojë potencialin e tyre për aktivitete frytëdhënëse.

Riinvesti obligohet që për Komunën e Gjilanit ti kryej këto aktivitete dhe shërbime :

- Organizimin e katër punëtorive tri ditore për antaret e ekipës të ZHEL
- Dhënjën e asistencës teknike për ekipin e strategjisë ZHEL,
- Hartimin dhe aprovimin e strategjive të zhvillimit ekonomik lokal,
- Hartimin e projekteve dhe implementimin e tyre,
- Organizimin e një konference të donatorëve dhe
- Udhëtimet studiuëse / i mundëshm

Qëllimi i programit është :

- Aftësimi i komunave në përgatitjen e strategjive zhvillimore, pra ngritja e kapaciteteve të Administratave Komunale dhe
- Hartimi i Strategjisë Afatmesme Ekonomike Lokale

*** Asociacioni i Komunave të Kosovës / AKK**

Programin e Partenitetit Nderkomunal ka përqëllim t'i ndihmoj komunat drejt zhvillimit të infrastruktures ndërkomunale dhe të kthyerit (integritit), ky projekt do të realizohet në koperim të ngushtë në mes të AKK-së dhe Grupit për Zhvillim të Infrastrukturës Rurale dhe Urbane , programi kërkon që 15 % të vlerës së projektit të financohet nga Komunat, ndërsa pjesa tjetër të financohet nga donoret / nese identifikohen, Si kusht themelore për keto projekte është dy ose më shumë komuna duhet të bashkëpunojnë për identifikimin në punët për infrastrukturën. Ku projekt do të përforcoj bashpunimin nderkomunal dhe rajonal që do të kishte një qëllim rreth qarkullimit të lirë të njerëzve dhe zhvillimit ekonomik në rajon. Projektet e propozuara mund të jenë të ndryshme nga lamia e infrastruktures së përgjithshme si: elektrike, ujësjellës dhe kanalizim, transport, ndërtesa publike, objekte shëndetësore . Komuna e Gjilanit në muajin prill'04 ka aplikuar në këtë program me 9 projekte / transport, ujësjellës, ndërtesa publike / ku janë të përfshira projekte ndërkomunale dhe ndërkufitare .

*** CRS / Catholic Relief Sevicees**

Programi i Pajtimit dhe Bashkëpunimit Nderkufitar Gjilan – Kumanovë - qëllimi i këtij programi është 3 vjeçar dhe financohet nga CRS/USAID, qëllimi është të avansoj pajtimin nderetë dhe demokracinë lokale në komunitetet nderkufitare në Evroën juglindore . Aktivitetet thelbësore janë rritja e shkëmbimeve dhe kontakteve rurale që do të shpërfaqin prodhimtarinë dhe të tregtisë dhe aktivitetet kulturore dhe të rinisë .

*** UN-HABITAT**

Nëdhimja Komunave të Kosovës në Hartimin e Planeve Strategjike Zhvillimore Urbane .

*** Iniciativa për Qeverisjen Lokale (IQL) -**

Gjilani është njëra nga pesë komunat e Kosovës, e cila është përfshirë në programin e USAID-it për forcimin e qeverisjes lokale dhe me 22/09/04t ka nënshkruar edhe marrëveshjen e mirëkuptimit. Sipas kësaj marrëveshje, Gjilani, Gjakova, Podujeva, Shtërpca dhe Theranda, prej një tetorit 2004, do të fillojnë zbatimin e programit trevjeçar, i cili synon të përmirësojë menaxhimin, zhvillimin ekonomik lokal dhe shtimin e pjesëmarrjes publike në qeverisjen lokale. Iniciativa për Qeverinë Lokale do të ndihmojë që komunat t'i përmirësojnë rolet dhe përgjegjësitë e tyre në pajtim me parimet e Kartës Evropiane për Vetëqeverisjen Lokale.

15. **Kronologji e rrjedhave të komunës / 2004**

- Më 11.01.04 u bë rivarrimi i eshtrave të dëshmorëve të rënë 20 vjet më parë për lirin e Kosovës, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha njëzet vjet më parë kishin rënë së bashku në ballafaqim me forcat serbe, njëzet vjet kishin qëndruar të ndarë në varresat e e qytetit të Gjilanit, për t'u rivarrosur në varresat e dëshmorëve në Gjilan .
- Më 14.01.04 kryetari i komunës z. Lutfi Haziri u takua me kryetarin e Komunës së Bujanocit z. Nagip Arifin, gjatë takimit u tha se në të dy komunat ka një numër të madhë të refugjatëve të cilët përshkak të luftërave kanë ndërruar vendqëndrimet e tyre, po ashtu gjatë takimit u tha se Gjilani dhe Bujanoci krijojnë ura lidhëse ndërmejt vete dhe për rajonin .
- Më 16.01.04 u mbajtë seanca e parë e Kuvendit Komunal, pika më e nxehtë e punimeve ka qenë raporti i revizionit të mbrendshëm finaciari të cilën e ka paraqitur z. Sherafedin Latifi i cili ka theksuar se gjatë vitit të kaluar ishin bërë 34 kontrole, prej tyre 10 të rregullta e 24 të pjesërishtme – pa paralajmërime, këshillëtarët përkrahin raportin e revizionit të brendshëm por edhe paraqiten vrejtit e tyre .
- Më 17.01.04 fillon manifestimi kulturor „ Flaka e Janarit 04 „ në të cilën do të mahen akademia përkujtimore për dëshmorët e kombit, një koncert i muzikës klasike si dhe do të hapet ekspozita e arteve pamore. Po ashtu nga 19 –23 janar do të jenë veprimtarit skenike të Teatrove të Tiranës, Shkupit, Gjakovës dhe Gjilanit, manifestimi do të përmbyllet me 30 janar me Orën e madhe letrare dhe publikimin e rezultateve të konkursit .
- Më 20.01.04 Ministria e Kulturës e Kosovës i ka njohur teatrit të qytetit në Gjilan statusin profesionist. Përfaqësuesi nga kjo Ministri, Zeqir Hamiti i ka dorëzuar të marten në Gjilan kryetarit të komunës, Lutfi Haziri vendimin për teatrin e Gjilanit, të cilit i jipet statusi profesionist.
- Me 23.01.04 Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Gjilan, në një raport që ka publikuar për punën e Kuvendit Komunal, Komitetet dhe Drejtoritë, ka vlerësuar se është punuar në frymë tolerante dhe demokratike, por ka shtuar se shumica e këshilltarëve kanë qenë pasiv nëpër mbledhje gjatë vitit 2003. Përndryshe, Kuvendi Komunal i Gjilanit, sipas monitoruesve të këtij Këshilli, ka përbushur planin vjetor të punës për vitin 2003, duke mbajtur 12 seanca të rregullta dhe 2 tjera të jashtëzakonshme.
- Me 28.01.04 në bazë të një hulumtimi dhe raporti që kanë bërë mjekët e gjinekologjisë në Gjilan, shihet se gjatë katër viteve të fundit ka patur një ulje të ndjeshme të shkallës së natalitetit, Dr. Shaban Rexhepi, shef i repartit të gjinekologjisë në spitalin rajonal të Gjilanit, gjatë prezentimit të raportit të punës së këtij institucioni për vitin 2003, tha se gjatë katër viteve të fundit këtu kanë lindur 13 mijë e 881 fëmijë (më shumë meshkuj), kanë ndodhur 165 vdekje antenatale dhe 186 vdekje neonatale, sipas dr. Rexhepit, personeli i këtij repartit, vitin që shkoi ka kryer 8 mijë e 58 shërbime të ndryshme mjekësore, gjatë po të njëjtit vit, në këtë repart kanë lindur 2.872 nëna, kurse mortaliteti ka qenë 22,4 promila, ndersa Gjinekologu Nexhat Sherifi tha se pesha mesatare e bebave ka qenë 3.240 gramë, kurse ka arritur të mijetojë edhe fëmija me peshën 850 gramë, i cili ka ardhur në jetë po në këtë repart. Ndërkaq, pesha më e madhe e një fëmije të lindur këtu ka qenë afër 6 kilogramë, përkatësisht 5.850 gramë.
- Me 30.01.04 Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri është takuar me drejtuesit e institucioneve kryesore për rajonin e Gjilanit, komandantin e TMK-së, Zona e 6-të, Imri Ilazi, nënkolonelin e SHPK-së, Reshat Maliqi, kryetarin e gjykatës së qarkut, Ymer Huruglica, kryeprokurorin Sabit Maliqi, drejtorin e spitalit regional, dr Ukshin Ismajli drejtori i Qendrës për mbrojtje sociale, Arben Mehmeti dhe ka biseduar me ta rreth objektivave të përbashkëta si dhe obligimet në përbushjen e standardeve, të cilat kërkojnë prej kosovarëve nga bashkësia ndërkombëtare.
- Më 31.01.04 në prag të festës së Kurban Bajramit, komuna e Gjilanit ka shpërndarë ndihma për 320 familje, të cilat jetojnë në kushte më të vështira se të tjerët. Komuna ka dashur që në këtë ditë të veçantë për qytetarët e besimit islam, të mos ndjehet askush i harruar, por secila familje të ketë mundësi t'i ofrojë fëmijët e vetë pranë një sofre më të begatshme. Pakoja ushqimore ka peshuar mbi 70 kilogramë dhe ka përmbytur miell, kripë, sheqer, vaj, oriz, detergjente, lëngje dhe gjera tjera të nevojshme .
- Me 05.02.04 juria profesionale artistike për zgjedhjen e punimit për shtatoren e Agim Ramadanit, në përbërje: akademik Rexhep Ismajli, kryetar dhe Eqrem Basha, Anton Çuni, Jetullah Haliti, Rexhep Ferri dhe Xhemajl Hyseni, anëtarë, pasi i ka shikuar e vlerësuar të gjitha punimet e arritura në konkursin e shpallur nga Kuvendi Komunal dhe Shoqata e Veteranëve të Luftës të Brigadës “Agim Ramadani” ka vendosur që vendin e parë t'ia ndajë punimit të autorit Gani Bajraktari, punimi i Gani Bajraktarit është zgjedhur për shtatore të Agim Ramadanit, e cila pasi të jetë punuar do të vendoset në sheshin përpara teatrit të qytetit .
- Me 12.02.04 fëmijët e grupmoshave 4-5 vjet të entit parashkollor “Ardhmëria II” në Gjilan kanë vizituar sot Shërbimin Policor të Kosovës në Gjilan dhe për disa çaste janë shoqëruar me uniformat, të cilat, në sytë e yllkave dhe fotosave reflektojnë dashuri. Drejtoresha Tylaj Hasanaj thotë se qëllimi i kësaj vizite ishte që fëmijët të ndjejnë afërsinë me policët dhe të kërkojnë ndihmën e tyre në rrugë, saherë që mund të kenë nevojë.
- Më 15.02.04 Gjilani dhe Lypjani dakordohen për ndërtimin e rrugës Ponesh-Zhegovc- Sllovi, Kryetari i komunës së Lypinait, Xhevat Olluri, në një takim që pati të premten me kryetarin e komunës së Gjilanit, Lutfi Hazirin, ku ai erdhi me bashkëpunëtorët e tij për të biseduar rreth mundësive për ndërtimin e rrugës Gjilan-Lypjan, nga drejtimi i Zhegotit ose Vërbicës, tha se vetëm me komunën tuaj, tash për tash nuk kemi lidhje të drejtpërdrejta. Edhe komuna e Gjilanit do të ketë interesin e saj në këtë rrugë, sepse në relacion më të shkurtër do të lidhet me magjistralen dhe me komunën e Lypianit, ku gjendet aeroporti i Prishtinës, shpella e Gadimes, shtëpia korrektuese dhe nga do të kalojë edhe autoudha Tiranë-Durrës-Prishtinë.
- Më 16.02.04 fillon realizimi i projekti i rrugës Zhegër – Shurdhan e gjatë 8 kilometra që është financuar nga Ministria e Transporteve dhe Telekomunikacionit, në vlerë 527 mijë Euro, ndersa po realizohet nga kompania vendore “Bejta Comerc” e Gjilanit, realizimi i këtij projekti ka rëndësi të madhe jo vetëm për banorët e kësaj treve, por edhe për komunën e Gjilanit, sepse hapë perspektivë për zhvillimin e Grykës së Karadakut. Punimet në këtë rrugë kanë ngjallur shpresat e mbi 10 mijë banorëve të Grykës së Karadakut se një ditë mund të kthehen në vendlindjen e tyre, të cilën ishin detyruar ta braktisnin për shkak të kushteve të vështira për jetë.
- Më 17.02.04 bashkëpunimi ndërkufitar në rajon vazhdon me një takim të rinisë në Gjilan Bashkëpunimi ndërkufitar i komunave Gjilan-Preshevë-Kumanovë, një projekt ky që ka fituar përkrahje edhe nga Këshilli i Evropës, Pakti i Stabilitetit dhe Instituti Lindje-Përendim, ka vazhduar të marten në Gjilan, me një takim të të rinjve, të cilët kanë zhvilluar një debat rreth problemeve të përbashkëta si dhe bashkëpunimin e këtij mikroregjioni. Në takimin e Gjilanit, të rinjtë nga këto komuna, të moshës 16-18 vjeqare, në prani edhe të mësimitdhënësve të tyre si dhe përfaqësuesve të klubeve rinore, të cilët janë tubuar në objektin e

OSBE-së, kanë folur për çështje e tema, të cilat janë zgjedhur nga ata vetë. Programi ka për qëllim që t'i lehtësojë kontaktet ndërmjet këtyre komunave, pas konfliktit në të cilin ishte përfshirë ky rajon dhe t'i japë më shumë kuptim fjalës multietnicitet. Njëkohësisht synohet që në këtë mënyrë, duke inkurajuar takimet dhe dialogun ndërmjet të rinjve, t'iu ofrohet atyre mundësia të ndërtojnë një rrejt komunikimi të ndërsjellë në mikroregjion.

- Më 20.02.04 Komuna e Gjilanit është zgjedhur në listen definitive të pesë komunave pjesëmarrëse në projektin DELTA II që financohet dhe mbështet nga Institutin për Hulumtime Zhvillimore / RIINVEST me seli në Prishtinë & Institutin për Shogëri të Hapur / OSI me seli në Budapest, aktivitetet kyqe të projektit janë / organizimi i katër punëtorive, hartimi dhe aprovimi i strategjive të Zhvillimit ekonomik lokal, hartimi i projekteve dhe implementimi i tyre, organizimi i konferencës së donatorëve dhe organizimi i udhëtimit studiues në botën e jashtme.
- Më 24.02.04 Kryetari i komunës së Gjilanit dhe i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Lutfi Haziri, merrë pjesë në një vizitë dy ditore në Bruksel, gjatë vizitës është takuar me Stefanino Sannino, këshilltar i kryetarit të Komisionit Evropian, z. Romano Prodi si dhe me Stefan Lehne, drejtor për Ballkanin Përendimor në Këshillin e Bashkësisë Evropiane. Në këtë takim, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit nga disa shtete tjera, si Danimarka, Zvicra e të tjera si dhe përfaqësuesi i Paktit të Stabilitetit, z. Lutfi Haziri është përqëndruar te zhvillimi ekonomik lokal si dhe te bashkëpunimi ndërkufitar në rajon, i cili duhet të inkurajohet me projekte që sigurojnë një infrastrukturë më të mirë në komunat Gjilan, Kumanovë dhe Preshevë, si pjesë të mikroregjionit.
- Më 26.02.04 Klubi i Gazetarëve "Beqir Musliu" në Gjilan i ka bashkuar në një debat rreth projektit për rizhvillimin e qendrës së qytetit, udhëheqësit e komunës, subjektet politike, shoqërinë civile, ekspertët e ndërtimtarisë dhe arkitekturës, intelektualët e qytetit dhe të tjerët, ku ata i kanë shfaqur idetë dhe vizionin e tyre se si do të dëshironin të dukej në të ardhmen qyteti i tyre, i cili, siç u tha, nuk mund të identifikohet me diçka specifike nga arkitektura dhe urbanistika e kaluar dhe e tashme. Tema e tryezës "Për një pamje tjetër të qendrës së qytetit" ishte një kontribut i mirë në shtjellimin e projektit ideor për qendrën e Gjilanit.
- Më 02.03.04 Zyra regjionale e arsimit në Gjilan i ka bërë të njohur emrat e zëvendësrektorëve të rinj në 6 shkolla fillore dhe të mesme të kësaj komune, të cilët janë zgjedhur nga Ministria e Arsimit e Kosovës, në bazë të konkursit. Në arsimin fillor, zëvendësrektorë të rinj janë caktuar Ruhan Zymberi (Thimi Mitko), Sali Hasani (Musa Zajmi), Bahrije Veseli (Abaz Ajeti), Remzije Tahiri (Selami Hallaqi) dhe Shefqet Bekteshi (Zhegër), ndërsa në gjimnaz është zgjedhur Naser Aliu.
- Më 05.03.04 Këshilltarja për politikë në Zyrën Amerikane në Prishtinë, znj. Robin Blunt është takuar në Gjilan me kryetarin e komunës, Lutfi Haziri dhe në një bisedë me të, është njoftuar për gjendjen e përgjithshme në komunën më të madhe të sektorit lindor të Kosovës. Duke folur për zhvillimet në këtë komunë, Lutfi Haziri tha se Gjilani shquhet për nga përparimet që ka bërë në planin e integritetit të komuniteteve dhe ata sot përfaqësohen në të gjitha strukturat qeverisëse lokale.
- Më 06.03.04 me rastin e 7 marsit, ditës së mësuseit, Drejtoria e arsimit ka organizuar në Gjilan një manifestim rasti, ku kanë marrë pjesë mësimmëdhësit e shkollave fillore dhe të mesme, drejtues dhe veteranë të arsimit, deputetë të Parlamentit të Kosovës, udhëheqësit komunalë dhe të tjerë. Agim Rexhepi, drejtor i arsimit ka folur për historikun e zhvillimit të shkollës shqipe, me një përqëndrim të veçantë në rajonin e Gjilanit.
- Më 09.03.04 si në pjesët tjera të Kosovës, edhe në komunën e Gjilanit nisin përgatitjet në terren për rilevim aerofotogrametrik, kjo u bë e ditur në një takim pune mes kryeshefit ekzekutiv, z. Enver Muja dhe shefave të sektoreve të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër, Pronë dhe Banim, ku u bisedua rreth rëndësisë së madhe që ka për komunën e Gjilanit një aerofotogram i tillë, i cili këtu është bërë para 35 vitesh.
- Më 14.03.04 në organizim të Drejtorisë për kulturë, rini dhe sport të Kuvendit Komunal të Gjilanit dhe të Klubit të atlektikës "Gjilani", më 14 mars do të mbahet vrapimi "Gjilani 2004", i cili ka për qëllim ngritjen dhe afirmimin e vlerave sportive, ndërsa organizohet në shenjë nderimi të pranverës studentore 1981. Vrapuesit do të garojnë në dy kategori, Seniorët duhet të përshkojnë shtegun e gjatë 11.300 metra, ndërsa juniorët dhe veteranët do të garojnë për rezultat sa më të mirë në gjatësinë 4.300 metra, nisja do të jetë nga qendra e qytetit.
- Më 16.03.04 Komandanti i Brigadës Shumëkombëshe të Lindjes, gjenerali Rick Erlandson ka vizituar sot Gjilanin, ku është takuar me Lutfi Hazirin, kryetar dhe Xhemajl Hysenin, zëvendëskryetar të komunës dhe gjatë një bisede me ta është njoftuar me gjendjen dhe zhvillimet e përgjithshme në këtë komunë të sektorit lindor, e cila njëherësh është qendër e rajonit. Lutfi Haziri tha se Gjilani cilësohet si qytet i paqes dhe i përparimeve në Kosovë, si për nga niveli i sigurisë, ashtu edhe në planin e integritetit të komuniteteve, të cilat sot përfaqësohen në të gjitha strukturat qeverisëse lokale.
- Më 17.03.04 rastin tragjik që ndodhi dje në Mitrovicë, ku në përpjekje për t'i ikur rrezikut nga grupi i serbëve që po i kërcënonte ata, humbën jetën tre vogëlushë, e ka gjykuar sot ashpër Asambleja e fëmijëve në Gjilan, e cila është themeluar para një viti dhe qëllim të saj ka mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve po ashtu edhe udhëheqja e komunës së Gjilanit, përmes një deklarate që i dha zyrës për informim, u ka bërë thirrje qytetarëve që të tërhiqen nga protestat dhe të mos i kontribuojnë përkeqësimit të mëtejshëm të situatës, sepse përshakllëzimi i gjendjes nuk e ndihmon Kosovën në rrugën e saj të pavarësisë.
- Më 18.03.04 Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, gjatë një konference të përbashkët me liderët e tri subjekteve më të mëdha politike që përfaqësohen në Kuvend, që mbajtën të enjten pasdite, ka kërkuar nga të gjithë qytetarët e këtushëm që të angazhohen në uljen e tensioneve dhe kthimin e qetësisë, pas protestave të djeshme, të cilat morën një viktimitë, lanë 31 të lënduar, disa shtëpi dhe automjete të djegur si dhe pasoja të tjera, tani kur Gjilani ishte bërë një shembull i mirë progresi edhe për pjesët tjera të Kosovës, po ashtu Komiteti për Siguri dhe Emergjencë i Kuvendit Komunal të Gjilanit, në takimin e sotëm të mbrëmjes, pasi është njoftuar për vazhdimin e protestave edhe ditën e sotme, ka vendosur që të premtën të mos mbahet mësimi në pesë shkolla të mesme në qytet, ndërsa të shtunën të mos mbahet tregu.
- Më 24.03.04 - dita e 24 marsit nuk kaloi pa asnjë aktivitet në këtë qytet, në objektin e shkollës fillore "Thimi Mitko" u zbulua murali që simbolizon paqe për të gjithë në Kosovë, Kryetari i komunës, Lutfi Haziri, zëvendëskryetari Xhemajl Hyseni, kryeshefi Enver Muja, komandanti i KFOR-it, koloneli Richard Jonson, këshilltari i UNMIK-ut për Gjilan, Charles Messier, kryetari i AAK, Fadil Gashi si dhe përfaqësuesi i komunitetit turk, Kemal Shahin kanë tërhequr bashkarisht pëlhurën e gjerë nga murali dhe para tyre është shfaqur një dritare e hapur, harta e Kosovës me një libër në mes të saj si dhe dy pëllumba nga të dy anët e pikturës, parashkollorët e "Thimi Mitko" u kanë dhuruar lule ushtarëve të KFOR-it amerikan.
- Më 26.03.04 Parashkollorët e qerdhes "Ardhmëria 2" në Gjilan janë ndihmuar me 500 € nga Federata e hendbollit të Kosovës, Kryetari i kësaj federate, Mexhid Devaja tha se mjetet janë grumbulluar nga ndeshja miqësore e zhvilluar në Gjermani, ndërmjet përfaqësueses së Kosovës dhe ekipit vendor të komunës së Essenit. Drejtoresha Tylaj Hasanaj, duke shprehur falënderim në emër të parashkollorëve të "Ardhmëria" tha se ky është një investim në të ardhmen dhe veçmas ka falënderuar përgjegjësin e sportit të komunës së Essenit në Gjermani, z. Rudolf Jelinek.

- 31.03.2004 Njëmbëdhjetë drejtori të shërbimit civil të komunës së Gjilanit, që nga nesër do të udhëhiqen nga drejtues të përkohshëm, meqenëse tetë drejtorëve të deritashëm u kanë mbaruar kontratat e punës më 31 mars, ndërsa tre të tjerë ishin caktuar më herët në këtë cilësi, Në administratën e përgjithshme, drejtor i përkohshëm është caktuar Sadri Arifi, në buxhet dhe financa – Ilmi Limoni, në urbanizëm – Mumin Kçiku, në ekonomi – Nuhi Nuhiu, në siguri dhe emergjencë – Halit Rexhepi, në shëndetësi – Nexhat Halili, në bujqësi – Zvonko Petkoviç, Ndërkohë, deri nesër do të përcaktohet edhe kandidati për drejtorinë e shërbimeve publike, Drejtoria për kulturë, Drejtoria për arsim si dhe Drejtoria për gjeodezi, që më herët udhëhiqen nga ushtruesit e detyrës, Bali Sahiti, Agim Rexhepi dhe Alban Qerimi.
- 06.04.04 Zëvendëskryedrejtor i Kosovës, Charles Brayshaw ka vizituar Gjilanin për të parë hapat që janë ndërmarrë nga institucionet e këtushme lokale në sanimin e gjendjes, pas trazirave të 17 e 18 marsit. Fillimisht ai ka shkuar në manastirin e Dragancës, ku është takuar me priftin Kirillo, kurse më vonë, në Partesh ka biseduar me liderët serbë dhe në selinë e UNMIK-ut në Gjilanin, me kryetarët e komunave të këtij rajoni.
- ME 08.04.04 KMDLNJ zgjedhë Gjilanin për të filluar debatet e përbashkëta për trazirat e marsit, pra Gjilani do të jetë komuna e parë në Kosovë prej nga KMDLNJ do t'i fillojë debatet e përbashkëta politike për trazirat e marsit 2004. Kështu kanë thenë të enjten në Gjilan përfaqësuesit e këtij Këshilli, Behxhet Shala, Ibrahim Makolli dhe Halime Morina gjatë takimit me kryetarin e komunës, Lutfi Haziri.
- Me 09.04.04 Klubi i gazetarëve "Beqir Musliu" në Gjilan, përkatësisht zyra për informim e Kuvendit të Komunës i kanë ballafaquar sot në një debat të hapur rreth statutit të komunës, shoqërinë civile dhe komisionin, i cili ka punuar në verzionin e ri të këtij dokumenti bazik të qeverisjes lokale, përpara se ai të shkojë për miratim në asamble, ku gjithashtu pritet të ketë një diskutim të gjerë.
- 12.04.04 Kryeministri i Kosovës, Bajram Rexhepi i shoqëruar nga ministri Ahmet Isufi, kryetari i Odës ekonomike të Kosovës, Ismaj Kastrati, kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri si dhe deputeti në Parlamentin e Kosovës, Ismail Kurteshi ka inkurajuar prodhuesit vendorë në fshatin Malishevë të komunës së Gjilanit, gjatë një vizite që i bëri serës së bujkut Sadri Rrahimi. Vetëm zhvillimi ekonomik dhe orientimi në veprimtaritë prodhuese do të krijojnë një perspektivë më të mirë për Kosovën, tha kryeministri Rexhepi, duke u zotuar se së shpejti do të ndryshohen politikat fiskale në të mirë të prodhuesve vendorë.
- Më 14.04.04 në Pogradë të komunës së Gjilanit, ka filluar meremetimi i rrugës së gjatë 14 kilometra, nga ky fshat i pjesës lindore të Kosovës, deri në Gjilan. Në një solemnitet rasti ku kanë marrë pjesë udhëheqja e komunës si dhe disa nga deputetët e zonës, kryetari i Gjilanit, Lutfi Haziri tha se kjo është një ditë e veçantë për banorët e 11 fshatrave të kësaj ane, të cilat do t'i përshkojë kjo rrugë, ose do të kalojë më afër tyre.
- Më 15.04.04 në fshatin Zhegoc të komunës së Gjilanit, me një manifestim popullor është shënuar sot pesëvjetori i betejës së 15 prillit 1999, ku në përlshje me forcat serbe ranë me dhjetra dëshmorë të kësaj ane, në fshatrat Vërbicë dhe Zhegoc janë zbuluar edhe pllakat për të rënë, Ilmi Hyseni, Feim Ajeti, Bashkim Ramadani, Ismet Ajeti, Fadil Ajeti, Enver Miftari, Sahit Baftiu, Kastriot Baftiu, Shahin Baftiu dhe Bahri Sadiku.
- Më 22 prill '04 Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Prishtinë ka nisur në Gjilan debatet ndëretnike në Kosovë, duke patur si qëllim riparimin e raporteve me komunitetet, pas trazirave të marsit. Sipas Ibrahim Makollit, seria e debateve, të cilat do të mbahen me temën «Marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë pas ngjarjeve të marsit 2004, perspektivat dhe pengesat» tenton të bëjë një identifikim të pengesave në marrëdhënieve ndëretnike dhe angazhimin e institucioneve vendore, UNMIK-ut dhe shoqërisë civile në krijimin e tolerancës dhe mirëkuptimit mes etnive të ndryshme në Kosovë. Komuna e Gjilanit ka qenë shembulli më i mirë në integrimin e minoriteteve para ngjarjeve të marsit dhe KMDLNJ, jorastësisht ka zgjedhur këtë qytet për të filluar debatet e saja, tha Makolli, në tryezën e KMDLNJ, ku morën pjesë Adem Demaqi, Pajazit Nushi, Lutfi Haziri, Azem Vllasi, Baki Sfirca, përfaqësues të UNMIK-ut dhe OSBE-së.
- Më 24 prill '04 në Londër të Britanisë së Madhe po mbahet konferenca tri ditore, e cila i kushtohet zhvillimit ekonomik të Kosovës, ku së bashku me përfaqësuesit tjerë kosovarë po merrë edhe kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, Konferenca zhvillohet në "Wilton park", ndërsa është sponsorizuar nga ministria e jashtme norvegjeze dhe për tri ditë rresht, aty do të trajtohen problemet ekonomike në Kosovë.
- Më 31 prill 04 Kryeministri i Kosovës, Bajram Rexhepi i shoqëruar nga ministri Behxhet Brajshori e Ethem Qeku, së bashku me shefin e Zyrës Amerikane në Prishtinë, Marsi Ris kanë vizituar sot Gjilanin dhe në takimet me udhëheqës komunalë, liderë të komuniteteve dhe të subjekteve politike, strukturat vendore dhe ndërkombëtare të sigurisë, me përfaqësuesit e UNMIK-ut si dhe me rininë shumënike të kësaj komune kanë inkurajuar dialogun e brendshëm.
- Më 02.05.04 në kuadër të manifestimit "Ditët e Agimit" në fshatin Zhegër u kremtua dita e shkollës, ku një fjalë përshëndetëse e mbajti Shaqir Rustemi, i cili ndër të tjera tha se kjo shkollë, që nga viti i kaluar, me mburrje dhe krenari mban emrin e ish-nxënësit të saj, heroit të madh të luftës së Koshares, Agim Ramadani. "Ditët e Agimit" dhe bashkë me to edhe dita e shkollës sonë, më 3 maj, do të jenë ditët e lirisë, ditët e mburrjes, ditët e krenarisë, por edhe ditët e manifestimit të tërë asaj që ne e kemi obligim ta bëjmë për martirët, dëshmorët dhe heronjtë e lirisë së Kosovës.
- Më 4.05.04 në Gjilan është hapur festivali i muzikës për fëmijë "Polifest 2004", ku gjatë katër ditëve rresht do të prezantohen më shumë se tetëdhjetë këngëtarë të vegjël, nga të gjitha trevat. Gjilani po përjeton për të parën herë një festë të këtyllë të këngës, Polifesti organizohet nga produksioni muzikor "Polifonia" i Prishtinës, në bashkëpunim me Kuvendet Komunale në Gjilan dhe Ferizaj.
- Mesi i mujit maj Kryeministri Bajram Rexhepi dhe Lutfi Haziri Kryetari i komunës së Gjilanit përruar fabrikën e ujit "Dea" e cila është një investim privat i vëllezërve Shala.
- Me 28 maj 04 një delegacion i lartë i BE-së viziton Gjilanin, Peter Backer, kryesues i delegacionit tha se Bashkësia Evropiane dëshiron që të gjitha komunitetet në Kosovë ta shohin Prishtinën si qytet kryesor të tyre, ndërsa rikujtoi shumicën shqiptare se ata kanë për obligim që të garantojnë shërbime të barabarta për të gjithë qytetarët. Gjatë vizitës në Pasjan, kryetari i komunës Lutfi Haziri, si shenjë përkrahje për ekonominë e vogël, bleu një kovë të llamarinës në një dyqan serb.
- Më 31.05.04 një grup i fëmijëve të qerdhes "Ardhmëria 2" në Gjilan, së bashku me drejtoreshen Tylaj Hasanaj, për nder të ditës ndërkombëtare të fëmijëve, kanë vizituar sot zyrën e kryetarit të komunës, ku janë pritur me dhurata, ndërsa Egzon Bajrami, kryetar i Asamblesë së Fëmijëve të Gjilanit i ka përshëndetur ata dhe iu ka uruar mirëseardhje.
- Me 31.05.04 Këshilli organizativ për ngritjen e monumentit të Rexhep Mala e Nuhi Berisha ka vendosur që të mërkurën në Gjilan të vendoset gurthemeli i lapidarit të këtyre dëshmorëve. Kuvendi i komunës së Gjilanit ka vendosur më herët për vendosjen e lapidarit, në sheshin, i cili është propozuar ta mbajë edhe emrin e dëshmorëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha. Në prani të

familjarëve, bashkëveprimtarëve, përfaqësuesve të institucioneve qendrore e lokale dhe të qytetarëve të shumtë, të mërkurën në Gjilan u vu gurthemeli i shtatores së dëshmorëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha, e cila parashihet që të zbulohet solemnisht më 15 qershor, në ditën e çlirimit të Gjilanit. Gurthemelin e shtatores e vendosën bashkarisht kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, bashkëveprimtari Ilmi Ramadani si dhe familjarët e dëshmorëve Berisha dhe Mala.

- Më 01.06.04 një delegacion i Shërbimit të Doganave të Kosovës ka vizituar të hënën Gjilanin dhe në një takim me kryetarin e komunës, Lutfi Haziri ka biseduar rreth përgatitjes për hapjen e pikës doganore në Myçibabë, ku paraprakisht duhet të ndërtohet infrastruktura e duhur që nevojitet për doganim të mallrave. Përfaqësuesit më të lartë të Doganave të Kosovës, Naim Huruglica, drejtor, Shkëlzen Mustafa, zëvendësdrejtor, së bashku me udhëheqësin e UNMIK-ut për dogana, kërkuar që komuna të sigurojë hapësirën e duhur në lokacionin e Myçibabës, ku duhet të ngriten kapacitete doganore, e cila mundëson qarkullimin e mallrave përmes procedurave të rregullta.
- Më 04.06.04 Peter Rondorf, shef i zyrës gjermane në Prishtinë, gjatë vizitës në Gjilan, tha se është i inkurajuar nga mënyra se si punohet në këtë komunë për zgjidhjen e problemeve të ndryshme. "Në Kosovë do të kishte më pak probleme, sikur edhe komunat tjera të punonin kështu", tha Rondorf. Atje ku funksionojnë si duhet komunat dhe qytetarëve iu ofrohen shërbime të drejta dhe të barabarta, nuk ka nevojë për decentralizim të pushtetit, por ndoshta kjo është e nevojshme të bëhet në komunat e mëdha, siç është Prishtina, e cila nuk mund të garantojë shërbime të mira për një numër aq të madh të banorëve, sa ka kryeqyteti, tha më tutje Peter Rondorf. Gjatë kësaj vizite në Gjilan, ku z. Rondorf i dorëzoi bibliotekës së qytetit "Fan Noli" një fond librash në gjuhën gjermane si dhe një numër të disqeve, shefi i zyrës gjermane, më parë u takua me udhëheqjen e komunës dhe nga Lutfi Haziri, kryetar dhe Xhemajl Hyseni, zëvendëskryetar u njoftua për gjendjen e përgjithshme. Lutfi Haziri tha se komuna e Gjilanit, krahas angazhimeve që po bënë për sanimin e pasojave të marsit dhe kthimin e të zhvendosurve, është duke inkurajuar edhe dialogun ndërmjet komuniteteve, ose dialogun mes fqinjve, me qëllim që të rikthet mirëbesimi i ndërsjellë.
- Nga 12-15 qershor mbahet festivali "Gurra popullore 2004" për nder të ditëve të çlirimit të Gjilanit, në këtë komunë do të mbahet festivali kombëtar i folklorit "Gurra popullore 2004", i cili do të tubojë ansamble dhe grupe shqiptare të folklorit nga të gjitha trevat shqiptare. Me rastin e pesëvjetorit të çlirimit të Kosovës dhe "ditëve të lirisë së Gjilanit", kryetari Lutfi Haziri u ka drejtuar një mesazh urimi qytetarëve të kësaj komune, ku i përgëzon ata për kontributin e përgjithshëm që po japin në ndërtimin e vendit dhe të institucioneve demokratike. Me 15 qershor në sheshin përpara hotelit "Kristal" në Gjilan, në një manifestim të veçantë që u zhvillua në kuadër të ditëve të lirisë, u zbulua shtatorja e dëshmorëve Rexhep Mala e Nuhi Berisha, të cilët ranë para njëzet viteve në Prishtinë, pas një rezistence të armatosur me forcat serbe.
- Me 18 qershor shoqata e mergimtarëve tanë në Zvicër "Agim Ramadani-Sali Çeku" ka siguruar 26 shtretër emergjent për tri qytete të Kosovës. Isa Agushi, udhëheqës i shoqatës i dorëzoi të enjten në Gjilan kryetarit të komunës Lutfi Haziri 10 shtretër të këtij destimi, të cilët janë shumë të nevojshëm. Duke e pranuar ndihmën, gjatë një ceremonie ku ka marrë pjesë edhe Shefqet Murtezi, drejtor i Shtëpisës së Shëndetit në Gjilan dhe këshilltar komunal, z. Lutfi Haziri ka falënderuar Isa Agushin si dhe anëtarët tjerë të shoqatës "Agim Ramadani - Sali Çeku", të cilët kanë siguruar shtretër mjaft të shtrenjtë, por edhe shumë të nevojshme.
- Me 21 qershor mbahet takimi i dialogut ndërfqinjësor në këtë takim, pos përfaqësuesve të komunës dhe atyre të komuniteteve, kanë marrë pjesë edhe zyrtarë diplomatike amerikane, britaneze, gjermane, italiane, franceze, holandeze në Prishtinë, pastaj përfaqësuesi i Solanës për Kosovë, përfaqësues të UNMIK-ut, të KFOR-it, deputetë të Parlamentit të Kosovës nga komuna e Gjilanit, nga të dy përkatësitë etnike, këshilltarë komunalë, liderë të subjekteve politike dhe të tjerë.
- Me 23 qershor mbahet takimi / Agjenda : Mbrojtja e pyjeve nga dëmtuesit ilegalë në rajonin e Gjilanit, ne takim moren pjes strukturat e këtyre komunale, Autoritetin Pyjor të Kosovës, AKM-në, UNMIK-un, KFOR-in, SHPK-në dhe të tjerë, për të shtjelluar problemin dhe për të koordinuar aktivitetin në segmentin e mbrojtjes së pyjeve nga dëmtimet .
- Më 2 korrik 04 / për nder të 2 korrikut, ditës së shpalljes së Deklaratës Kushtetuese në Kosovë, kryetari i komunës së Gjilanit dhe i Asociacionit të Komunave të Kosovës, Lutfi Haziri i ka përgëzuar sot të gjithë qytetarët, pa dallime etnike, me dëshirë që e ardhmja të jetë më e mirë për të gjithë.
- Me 8/09/04 Yldirim është qyteti i katërt evropian, pas Kukësit (Shqipëri), Ipperit (Belgjikë) dhe Luterbahut (Francë), me të cilin binjakëzohet komuna e Gjilanit. Një delegacion i kësaj komune, i përbërë nga Xhemajl Hyseni, zëvendëskryetar, Enver Muja, kryeshf ekzekutiv si dhe zyrtarë e përfaqësues tjerë nga komuniteti i arsimit dhe i biznesit po qëndrojnë për një vizitë tri ditëshe në Bursa të Turqisë.
- Me 15 shtator 04 Shefi i zyrës britaneze në Prishtinë, Mark Dickenson është takuar të mërkurën në Gjilan me kryetarin e komunës, Lutfi Haziri, ndërsa ka vizituar edhe fshatin Livoç i Epërm, i cili banohet me popullësi të përzier si dhe organizatën multietnike të të rinjve në qytet.
- Me 20 tetor 04 Shefi i Zyrës franceze në Prishtinë, Thierry Reynard e vizitoi Gjilanin dhe në një takim që pati me kryetarin e komunës, Lutfi Haziri u njoftua me zhvillimet e përgjithshme në këtë pjesë të Kosovës.
- Me 22 tetor 04 / Për banorët e fshatrave të Grykës së Kardakut, ka qenë një ditë e veçantë, sepse ka filluar asfaltimi i rrugës Zhegër – Shurdhan, që është pjesë e projektit të rrugës ndërkufitare Kosovë – Maqedoni. Fillimin e punimeve të fazës së dytë e kanë bërë ministri i Transportit dhe Telekomunikacionit, Zef Morina, kryetari i komunës, Lutfi Haziri dhe deputeti i Parlamentit të Kosovës nga kjo zonë, Sabit Rustemi.
- Me 22 tetor 04 / Shefi i Zyrës Amerikane në Prishtinë, Filip Golberg ka vizituar të premten Gjilanin dhe fillimisht është takuar me të zhvendosurit romë në lagjen "Dheu i Bardhë", ku ARC-ja është duke realizuar një program rindërtimi për komunitetin, të financuar nga qeveria holandeze, ndërsa pastaj, në takime të ndara, ka biseduar me kryetarin e komunës, Lutfi Haziri dhe zëvendëskryetarin e dytë, Bozhidar Periq.
- Me 21 nëntor /04 në organizim të Drejtorisë për Kulturë, mbrëmë në Gjilan u mbajt akademi përkujtimore për dr Xhavit Ahmetin, i cili humbi jetën tragjikisht, para tetë viteve, në rrugën e gjatë dhe të mundishme të mbrojtjes së pavarësisë së shkollës shqipe, duke qenë asokohe këshilltari për arsim i presidentit Ibrahim Rugova dhe deputet i Parlamentit të Kosovës.
- Me 28 nëntor /04 Festa e Flamurit, edhe në Gjilan u shënuar me manifestime të ndryshme kulturore e sportive. Drejtorja për Kulturë Rini e Sporte e Gjilanit, për nder të kësaj dite, organizoi në sallën e Teatrit Kombëtar një program me Shoqëritë Kulturoro-Artistike, të titulluar "Drejt nëntorit të tretë".

- Me 2/12/04 Gjenerali i TMK-së, Imri Ilazi dhe koloneli i SHPK-së, Reshat Maliqi janë nderuar me Mirënjohje nga kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, në një pritje që ai ka organizuar me udhëheqësit rajonalë të institucioneve, para se të kalojë në detyrën e re, në Ministrinë e Pushtetit Lokal.
- Më 21/12/04 mbahet mbledhja e rregullt e Asambles Komunale ku z. Xhemal Hyseni është zgjedhur kryetar i Kuvendit Komunal të Gjilanit, Lirije Kajtazi zëvendës kryetare, derisa Lutfi Haziri, kryetar i deridjeshëm, përfundimisht është përshëndetur me këshilltarët e Asambles Komunale të Gjilanit .

Përgatitur nga : Fadil OSMANI Zyrtar për projekte